

# RREGULLORJA E KËSHILLIT TË STUBLLËS (KS)

## § 1

### Emri, statusi juridik dhe viti financiar

- Këshilli mban emrin “Këshilli i Stubllës”. Më poshtë vetëm shkurt “KS”.
- KS është organi më i lartë i vetëqeverisjes lokale në Stubëll (Komuna e Vitisë) dhe vepron në kuadër të ligjeve të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Kosovës.
- Selia e KS është në Stubëll.
- Vit financiar është viti kalendarik, që është edhe bazë orientuese për publikimin e raporteve vjetore

## § 2

### Stema, flamuri dhe vula

Stublla do të ketë stemën, flamurin dhe vulën zyrtare.

Për këtë qëllim do të formohet komisioni që do të shpallë konkursin zyrtar.

## § 3

### Qëllimet dhe detyrat

KS kujdeset për nevojat e Stubllës dhe ndikon në zhvillimin e saj sipas interesave të qytetarëve në kuadër të ligjeve të vetëqeverisjes lokale dhe kompetencave që i takojnë, siç janë:

- Mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i objekteve dhe zonave publike
- Mirëmbajtja e rrugëve, shesheve publike dhe emërtimi i tyre
- Përcaktimin e radhitjes së punëve në ndërtimin, renovimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe rrugëve publike
- Kultivimi dhe mirëmbajtja e pamjes publike të Stubllës dhe dekorimi i vendeve publike sipas rasteve solemne
- Përkrahja e shoqatave dhe shoqërive tjera në Stubëll, që veprojnë në kuadër të rregullores së përgjithshme
- Përkrahja dhe organizimi i manifestimeve që ndikojnë në kultivimin e traditës dhe të kulturës sonë
- Kultivimi i miqësive dhe partneriteteve me vendbanimet tjera
- Përkujdesja për rastet sociale sipas nevojave dhe mundësive
- Shqyrtimi i mundësive të investimeve për hapje të vendeve të punës dhe planifikimi i tyre
- Planifikimi i buxhetit vjetor dhe ndarja e tyre sipas vendimeve të KS
- Prezantimi i Stubllës

## § 4

### Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të KS

Të gjithë anëtarët e KS janë të obliguar që të veprojnë sipas rregullores së Këshillit të Stubllës. Anëtarët kanë të drejtë të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet që parashihen si qëllime të KS.

## **§ 5**

### **Kontributet financiare**

Grumbullimi i kontributeve financiare për Stubëll bëhet në shoqatat përkatëse në Diasporë dhe në Këshillin e Stubllës sipas vendimeve të këtyre organeve.

Shoqatat dhe Këshilli i Stubllës vendosin në mënyrë autonome për ndarjen e këtyre mjeteve për qëllime të përbashkëta të Stubllës apo të KS-ës.

## **§ 6**

### **Organet e Këshillit të Stubllës**

Organe e KS-ës janë:

- Mbledhja e përgjithshme me popull
- Anëtarët e KS-ës
- Kryesuesi i KS-ës
- Këshilli mbikëqyrës i implementimit

## **§ 7**

### **Mbledhja e përgjithshme me popull**

Mbledhja e përgjithshme me popull mbahet së paku një herë në vit dhe ka për qëllim:

- Informimin e banorëve të Stubllës me punën e këshilleve dhe shoqatave
- Paraqitjen e raporteve të punës dhe raporteve financiare
- Pranimin e propozimeve dhe planeve nga banorët
- Planifikimin e punëve dhe projekteve të ardhshme
- Koordinimin e punëve ndërmjet këshilleve, shoqatave dhe banorëve

## **§ 8**

### **Kryesia e KS**

Kryesia e KS përbëhet nga 14 anëtarë dhe është organi kryesor vendimmarrës i KS-ës.

Anëtarët e KS-ës caktohen njëkohësisht me zgjedhjet e kryesive të Këshillit të Fshatit dhe të shoqatave në Diasporë, apo në raste të ata veçanta mund të delegohen nga ato organe.

Kryesia e KS-ës është përgjegjëse për gjitha detyrat në KS, përderisa këto detyra nuk iu janë caktuar ndonjë organi tjetër në bazë të rregullores apo ndonjë vendimi tjetër.

Detyrat kryesore të kryesisë së KS janë:

- udhëheqja e punëve aktuale
- përgatitja dhe thirrja e mbledhjeve të kryesisë dhe të atyre me popull
- zbatimi i vendimeve të këtyre mbledhjeve
- përgatitja e planit dhe buxhetit vjetor
- hartimi i raportit vjetor

Kryesia e Këshillit të Stubllës (KS) përbëhet nga 14 anëtarë:

- 7 anëtarë të Këshillit të Fshatit (6 vota)
- 1 anëtarë i Këshillit të Kishës (Famullitari)
- 2 anëtarë të Kryesisë së Shoqatës “Stublla” në Zvicër
- 2 anëtarë të Kryesisë së Shoqatës “Stublla” në Itali
- 1 anëtarë të Kryesisë së Shoqatës “Stublla” në Gjermani
- 1 anëtarë të Kryesisë së Shoqatës “Stublla” në Austri

Anëtarët e KS zgjidhen me vota të lira dhe të fshehta në Stubëll dhe Diasporë, për secilin organ veç e veç, dhe zgjidhen njëkohësisht me zgjedhjen e kryesive të këtyre organeve. Këshilli i Parë i Stubllës (KS) duhet të formohet nga zgjedhjet e reja më së largu deri në shtator 2009. Mandati i KS-ës është dyvjeçar.

Për t'u aprovuar një vendim i KS-ës nevojiten së paku 2/3 e votave pozitive të anëtarëve të tij (së paku 9 vota "për").

## **§ 9**

### **Kryesuesi i KS-ës**

Kryesuesi i KS-ës kryeson mbledhjet e kryesisë dhe përfaqëson KS-në jashtë. Kryesuesi i KS-ës është zakonisht kryetari i Këshillit të Fshatit në Stubëll i zgjedhur sipas rregullores. Në rast nevojë detyrën e kryesuesit mund ta ushtrojë ndonjë anëtarë tjetër i kryesisë në bazë të marrëveshjes paraprake të këtij organi me shumicë votash.

## **§ 10**

### **Këshilli mbikëqyrës i implementimit**

Këshilli mbikëqyrës i implementimit është organi që kujdeset për zbatimin e rregulloreve dhe vendimeve që kërkohen nga KS dhe njësitë më të vogla (Këshillet dhe Shoqatat). Mandatin e Këshillit mbikëqyrës të implementimin është i njëjtë sikurse edhe i Këshillit të Stubllës.

## **§ 11**

### **Informimi publik dhe arkivi**

KS duhet të caktojë redaksinë dhe ekipin teknik për punimin e një faqeje zyrtare të internetit për Stubëll, për themelimin e një gazete zyrtare dhe themelimin e arkivit.

Faqja e internetit duhet të punohet nga redaksia dhe ekipi teknik, kurse të menaxhohet dhe financohet (në rast nevojë) nga KS ose sponsorët (reklamata).

Ky ekip në bashkëpunim me KS-në duhet të publikojnë të gjitha njoftimet, publikimet dhe shkrimet që kanë të bëjnë me informimin sa më të mirë që qytetarëve të Stubllës dhe të aktiviteteve të tyre.

Si informim shtesë duhet të themelohet edhe një gazetë zyrtare, për publikimin e punës dhe aktiviteteve të KS-ës dhe të gjitha shoqatave dhe organeve tjera të Stubllës në vendlindje dhe diasporë.

Gazeta zyrtare duhet të dalë rregullisht (p.sh. 4 herë në vit) dhe të shpërndahet në të gjitha shtëpitë në Stubëll dhe Diasporë.

KS duhet po ashtu të themelojë edhe arkivin për dokumentimin e aktiviteteve të tij në formë të shkruar.

## **§ 12**

### **Hyrja ne fuqi**

Kjo rregullore është miratuar në "Tryezën e Rrumbullakët" në Koblenz më 1 maj 2009.